LAJME TË MIRA NGA

SUNDIMI I LIGJI

RAPORTI TREMUJOR 10



FILLIMI I FUSHATËS KOMBËTARE ‘1 NË 5 – STOP DHUNËS SEKSUALE NDAJ FËMIJËVE’

KALIMI NGA PARIMET NË PRAKTIKË – HARTIMI I LIGJEVE DHE MASAVE PËRMES QASJES QË BAZOHET NË TË DREJTAT E NJERIUT (QBDNJ)

KONFERENCA E NIVELIT TË LARTË MBI FORCIMIN DHE EFIKASITETIN E PAVARËSISË SË GJYQËSORIT

UDHËZUES PËR HETIME EFEKTIVE ONLINE TË MASHTRIMIT

EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

SHKURT 2025

KY RAPORT U FINANCUA NGA BASHKIMI EVROPIAN. PËRMBAJTJA E TIJ ËSHTË PËRGJEGJËSI E VETME E LUDËIG BOLTZMANN GESELLSCHAFT - INSTITUTI I TË DREJTAVE THEMELORE DHE TË NJERIUT (LBI-GMR) DHE NUK PASQYRON DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E BASHKIMIT EVROPIAN.

Financuar nga
Bashkimi Evropian

PARATHËNIE



Diter SHINDLAUER

Udhëheqës Ekipi, Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit

"Po e shfrytëzojmë këtë botim që të vazhdojmë të mbajmë lartë moralin dhe etikën e besimit në një arsye të shëndoshë për ndryshim, reforma dhe proces të vazhdueshëm përmirësimi. Për të bërë këtë, do të flasim mbi hapat e bëra përpara dhe do të festojmë për to në mënyrë që të mos humbasin në lajmet jo aq pozitive që janë gjithmonë më të zëshme."

I dashur lexues,

Ky raport i tremujorit të dhjetë është mjaft përmbajtësor. Është përplot me ngjarje që pritet të ndodhin por edhe me diskutime mbi çështje serioze. Një e dhënë mjaft serioze statistikore është fakti që në Evropë një në pesë fëmijë përjeton ndonjë formë të dhunës seksuale. Kjo statistikë patjetër që është alarmante, dhe duke qenë se ka të bëjë me një çështje që nuk është e këndshme dhe që shpesh heshtet, duhet trjatuar me diskutim dhe vetëdije publike. Prandaj, projekti ynë shfrytëzoi rastin e Ditës Botërore për Parandalim të Eksploatimit, Keqpërdorimit dhe Dhunës Seksuale ndaj Fëmijëve për të shënuar fillimin e fushatës kombëtare “1 në 5—stop dhunës seksuale ndaj fëmijëve” në nëntor 2025. Dhuna seksuale ishte edhe tema e një punëtorie për forcim të kapaciteteve për tridhjetë prokurorë publikë dhe gjykatës në bashkëpunim me Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve, që diskutuan mbi qasjet dhe zgjidhjet praktike për të rritur mbrojtjen e viktimave. U mbajt trajnim tre ditor për trajnerët për forcim të profesionalizmit brenda Qendrës për Punë Sociale për mbrojtje të viktimave nga dhuna me bazë gjinore me fokus në nevojat reale të viktimave nga dhuna me bazë gjinore. Pjesëmarrësit theksuan sidomos efektivitetin e ushtrimeve interaktive dhe ambientin e këndshëm si bazë për të trajtuar çështje kaq të rënda siç është dhuna me bazë gjinore.

PARATHËNIE

U zhvilluan edhe aktivitete të tjera siç janë trajnimet kundër trafikimit ilegal të drogës dhe mashtrimeve online, duke forcuar në mënyrë të drejtpërdrejtë kapacitetet e institucioneve që trajtojnë këto çështje. Trajnimi praktik mbi analizën dhe procesimin e të dhënave për Komisionin Shtetëror për Mbrojtje nga Korrupsioni forcoi aftësinë e këtij Komisioni për të procesuar vëllim të madh të të dhënave, duke mbështetur aktivetet proaktive anti-korrupsion që bazohen në prova.

Ju sugjeroj të lexoni intervistën me Adem Çuçulin, kryetarin e sapozgjedhur të Komisionit Shtetëror për Mbrojtje nga Korrupsioni. Ai flet për prioritetet strategjike që ka dhe për sfidat që vazhdojnë të jenë prezente në këtë institucion gjatë një periudhe të ndërtimit të besimit, integritetit dhe rritjes së kapaciteteve. Fjalët e tij plot optimizën për të ardhmen nxisin shpresë.

Në aspektin strategjik,ky raport përmban edhe një raport të shkurtër mbi konferencën e fundit të nivelit të lartë mbi forcimin e efikasitetit dhe pavarësisë së gjyqësorit, që u ndoq me interes të madh, si dhe vlerësime të sinqerta mbi mungesat momentale por edhe një sërë shpjegimesh për shkaqet që shkaktojnë ato, bashkë me rrugën që duhet ndjekur për tu përmirësuar. Poashtu realizuam edhe Forumin e Impulseve mbi zbatimin praktik të Qasjes që ka për bazë të Drejtat e Njeriut, ku u prezantua një doracak shumë praktik i hartuar nga ekspertët tanë (mund ta shkarkoni nga faqja jonë e internetit). Në këtë ngjarje iu dha formë një mjeti që duket shumë i komplikuar duke e bërë praktik dhe të përdorshëm për të ofruar mendime, strategji, politika dhe ligje. Ditët e hapura brenda gjyqeve dhe prokurorive publike, dhe idetë e reja për përdorim të mediave sociale nga prokurorët publikë shtuan transparencën e gjyqësorit dhe prokurorisë publike.

Uroj që edhe ju nga ky raport të ndaheni me përshtypje që është bërë progres, janë bërë përpjekje aktive për përmirësim dhe diskutime të sinqerta mbi sfidat.

Shijoni lajmet e mira!

Diter Shindlauer
Udhëheqës i Ekipit



JU PARAQESIM:

1 NË 5 – STOP DHUNËS SEKSUALE NDAJ FËMIJËVE

Me rastin e Ditës Botërore për Parandalim të Eksploatimit, Keqpërdorimit dhe Dhunës Seksuale ndaj Fëmijëve, në 18 nëntor 2025 filloi zyrtarisht fushata kombëtare "1 në 5 – Stop dhunës seksuale ndaj fëmijëve".

FORCIMI I EFIKASITETIT DHE PAVARËSISË SË GJYQËSORIT NË MAQEDONINË E VERIUT

Kjo konferencë shërbeu si forum strategjik për udhëheqësit e gjyqësorit, përfaqësuesit diplomatik dhe ekspertët e vendit dhe ata ndërkombëtarë për të diskutuar mbi hapat konkrete që duhen për të përafruar sistemin gjyqësor të vendit me standardet evropiane.

FORUMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT – FORUMI I IMPULSEVE

Të kaluarit nga parimet në praktikë – hartimi i ligjeve dhe masave përmes Qasjes që bazohet në të Drejtat e Njeriut (QBDNJ). Pjesëmarrësit ishin ndër të parët që eksploruan Doracakun e posabotuar Doracaku për zbatimin e QBDNJ i botuar në maqedonisht dhe anglisht.

Të flasim pak për...

- Fillimi i Fushatës Kombëtare '1 në 5 – Stop dhunës seksuale ndaj fëmijëve'
- Udhëzime për hetime efektive të mashtrimeve online të përpiluara për të mbështetur hetuesit e policisë
- Konferenca e nivelit të lartë mbi forcimin e efikasitetit dhe pavarësisë së gjyqësorit
- Hapja e gjyqeve për brezin e ri të juristëve
- Ndërtimi i kapaciteteve anti-korrupsion që udhëhiqen nga të dhënat për Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit
- Kalimi nga parimet në praktikë – Hartimi i ligjeve dhe masave sipas Qasjes që bazohet në të Drejtat e Njeriut (QBDNJ)
- Rritja e transparencës përmes përdorimit të përgjegjshëm të rrjeteve sociale nga prokurorët publikë
- Lufta kundër trafikimit ilegal të drogës – Sesioni II
- Intervista: Adem Çuçul: Lufta kundër korrupsionit përmes ndërtimit të integritetit, pavarësisë dhe kapaciteteve
- Forcim i kapaciteteve për mbrojtje më të madhe nga dhuna seksuale
- Lidhja e prokurorëve të ardhshëm me praktikën: Dita e Hapur e Zyrës së Prokurorisë
- Forcimi i sistemeve mbështetëse për të trajtuar nevojat e vërteta të viktimave nga DHBGJ

Fillimi i Fushatës Kombëtare ‘1 në 5 – Stop dhunës seksuale ndaj fëmijëve’

Një në pesë fëmijë në Evropë është viktimë e ndonjë forme të dhunës seksuale – nga ngacmimi dhe eksploatimi seksual, pornografia e fëmijëve, deri tek abuzimi online dhe ngacmimi nga bashkëmoshatarët. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjendja është poashtu serioze dhe shqetësuese: mes 2020 dhe 2024, janë raportuar 508 raste të dhunës dhe ngacmimit seksual ndaj fëmijëve, sipas Ministrisë së Brendshme (MB). Këto numra tregojnë qartë që dhuna seksuale ndaj fëmijëve është realitet që kërkon aksion, mekanizma të qartë të mbrojtjes dhe përgjegjësi të përbashkët.

Me rastin e Ditës Botërore për Parandalim të Eksploatimit, Keqpërdorimit dhe Dhunës ndaj Fëmijëve, fushata kombëtare “1 në 5 – Stop dhunës seksuale ndaj fëmijëve” filloi zyrtarisht në 18 nëntor 2025, me ngjarjen promovuese në Europe House në Shkup.

> “Statistikat janë të dhimbshme dhe serioze, por nuk duhet të mbesin thjesht numra. Çdo fëmijë ka një emër, ka familje dhe çdo fëmijë u beson të rriturve. E kemi për detyrë të bëjmë gjithçka që të sigurohemi që ky besim të mos keqpërdoret,” tha Dushan Tomshiq, Kryetar i Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi.



Kjo fushatë përmban video edukative, materiale të shtypura, dhe postera përshtatur për kontektsin lokal dhe që iu dedikohet fëmijëve, prindërve, kujdestarëve, mësuesve dhe profesionistëve që punojnë me fëmijë. Këto materiale do të shpërndahen nëpër shkolla, kopshte, dhe institucione publike në mbarë vendin, dhe poashtu do të jenë të disponueshme edhe në format digjital.

Këto aktivitete zbatohen në kuadër të projektit “Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit”, në partneritet me Komisionin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Avokatin e Popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me mbështetje nga Byroja për Zhvillim të Arsimit.

Kjo fushatë që realizohet me autorizim nga Këshilli i Evropës, ka për qëllim të rrisë vetëdijen publike, të inkurajojë fëmijët të ngrejnë zërin, dhe tu ofrojë të rriturve njohuritë dhe mjetet për të njohur, parandaluar dhe për të mbrojtur fëmijët nga dhuna seksuale.



Materialiet e fushatës: “1 në 5 – Stop dhunës seksuale ndaj fëmijëve”

Librat:

- Kiko dhe dora: MK / ALB
- Kiko dhe Shumëvetja: MK / ALB

Udhëzime:

- Kiko dhe dora: MK / ALB
- Kiko dhe Shumëvetja: MK / ALB

Postera:

- Kiko dhe dora _libri: MK / ALB
- Prekja: MK / ALB
- Sekreti: MK / ALB
- Biseda: MK / ALB
- Fotografimi: MK / ALB
- Prezenca digjitale: MK / ALB

Fletushka:

- Pra ky qënka ngacmim seksual: MK / ALB

Fletushka me dy faqe: Statistika nga Maqedonia e Veriut

- 1 në 5 – Fëmijëria nuk duhet të dhëmbë. Dëgjo, beso, mbro: MK / ALB

Video:

- Kiko dhe dora (3+): MK / ALB
- Kiko dhe Shumëvetja (4+): MK / ALB
- Thuaja dikujt që i beson (9+): MK / ALB
- Pra ky qënka ngacmim seksual (12+): MK / ALB
- Liqeni (14+): MK / ALB



Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Udhëzimet për hetime efektive të mashtrimeve online të hartuara për të mbështetur hetuesit e policisë

Si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të forcuar kapacitetet e institucioneve ligjzbatuese në Maqedoninë e Veriut për të hetuar mashtrimet online, ky projekt mbështeti përpilimin e Udhëzimeve për hetime efektive të mashtrimeve online. Këto udhëzime u përpiluan nga ekspertë të projektit në bashkëpunim me Sektorin e Krimit Kompjuterik brenda Ministrisë së Brendshme dhe u finalizuan në maqedonisht dhe anglisht në dhjetor 2025.

Para përpilimit të Udhëzimeve, hetuesit—sidomos oficerët e policisë nëpër stacione lokale policore—përballeshin me sfida të mëdha kur trajtonin raste të mashtrimeve online. Këto hetime shpesh kërkojnë kombinim kompleks të aftësive hetimore kompjuterike, financiare dhe të përgjithshme penale, kurse oficerët që janë pika e parë e kontaktit shpesh nuk kanë udhëzime praktike mbi identifikimin e hershëm të skemave të mashtrimit online dhe masave të menjëhershme hetimore që duhen ndërmarrë. Kjo shpesh bën që të kufizohet aftësia për të mbledhur të dhëna të mjaftueshme dixhitale, të bëhet ndërlidhja mes rasteve, dhe të parandalohet përsëritja e skemave të ngjashme të mashtrimit.

Këto Udhëzime u hartuan si mjete praktike për inspektorët, për të mbështetur njohjen e hershme të formave të ndryshme të mashtrimit online dhe zbatimin në kohë të aktiviteteve kryesore të hetimit. Me ato trajtohen sfida të veçanta që vijnë nga mashtrimi online, përfshirë këtu natyrën transnacionale që ka ky lloj mashtrimi, përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar, përdorimin e teknologjive të avancuara dhe mjeteve të anonimitetit, dhe faktin që provat gjenden kryesisht në hapësirën kibernetike. Edhepse ky dokument nuk zëvendëson vlerësimin që mund t'i bëhet secilit rast veç e veç, ofron kornizë të strukturuar për mbështetje të hetimeve më efektive dhe të koordinuara.

Udhëzimet e përfunduara iu dorëzuan zyrtarisht Sektorit të Krimit Kompjuterit, që më tutje do të vazhdojë shpërndarjen e tyre nëpër stacionet policore në mbarë vendin. Përdorimi i tyre pritet të japë kontribut për hetime më efikase, për ndërlidhje më të mirë të rasteve, dhe për forcim të përgjigjeve institucionale ndaj mashtrimit online.

Konferenca e nivelit të lartë mbi forcimin e efikasitetit dhe pavarësisë në gjyqësor

Në 3 shkurt 2026, projekti organizoi konferencën e nivelit të lartë ,,Forcimi i efikasitetit dhe pavarësisë së gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut". Kjo ngjarje shërbeu si një forum strategjik për udhëheqësit e gjyqësorit, për përfaqësuesit diplomatik, si dhe për ekspertët e vendit dhe ata ndërkombëtarë duke u dhënë atyre mundësi të diskutojnë mbi hapat konkrete që janë të nevojshme për të përafruar sistemin juridik të vendit me standarded evropiane.

Kjo konferencë u përqëndrua në prezantimin e Raportit mbi zbatimin e Strategjisë së Burimeve Njerëzore në Gjyqësor dhe Doracakut për Funksionim më të Mirë të Gjyqësorit, që të dy dokumente përpiluar nga ky Projekt. Me prezantim të këtyre gjetjeve ofruam analizë dhe kornizë për të trajtuar sfidat sistemike strukturore, përfshirë këtu edhe mungesën kritike të burimeve financiare dhe njerëzore brenda gjykatave. Me këtë iniciativë theksohen masat e caktuara që nevojiten për të ndërtuar një sistem gjyqësor më transparent, efikas dhe të pavarur.

Gjatë kësaj ngjarjeje, Mikalis Rokas, Ambasadori i BE-së theksoi që pavarësia dhe efikasiteti shkojnë bashkë, pra pa burime të duhura dhe të parashikueshme, nuk mund të sigurohet drejtësi cilësore. Igor Filkov, Ministri i Drejtësisë theksoi angazhimet e Ministrisë për hartim të ligjeve cilësore, të zbatueshme që shërbejnë si mjete të drejtësisë. Ai tha se reforma në drejtësi përbën një proces të vazhdueshëm, me rreth 30 ligje të hartuara për të inicuar ndryshime sistemike.



Aleksandar Kambovski, Kryetar i Këshillit Gjyqësor, foli për zbrazëtirat e mëdha në financa dhe të punësuar, duke theksuar që alokimi momental i 0.29% nga PVB është nën kërkesën ligjore prej 0.8% dhe nuk mjafton që të sigurohet gjyqësor që funksionon drejt. Afrim Fidani, Kryetar i Gjykatës Supreme, theksoi që suksesi i këtyre reformave strukturore varet nga etika dhe integriteti profesional brenda gjyqësorit, që janë shtyllat kryesore për tu rikthyer besimi publik.





Drejtësia efektive dhe e pavarur nuk është vetëm vlerë thelbësore e BE-së por një nevojë e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut. Përmes Projektit Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit, vazhdojmë të çojmë përpara këto reforma thelbësore me dialog të vazhdueshëm, me udhëzime ekspertësh, dhe duke promovuar standardet evropiane që ndihmojnë në rritjen e besimit publik që i duhet çdo komuniteti profesionist dhe të qëndrueshëm ligjor.





Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Hapja e gjykatave për brezin e ri të juristëve

Në fund të 2025 dhe fillim të 2026, projekti ynë vazhdoi me misionin për t'ia prezantuar gjyqësorin brezit të ri të juristëve. Në bashkëpunim me Gjykatën Themelore Penale, Gjykatën Themelore Civile, me Gjykatën e Apelit, dhe me Gjykatën Supreme në Shkup, organizuam disa Ditë të Hapura me qëllim të promovimit të transparencës dhe ndërtimit të besimit publik në sistemin e drejtësisë. Këto iniciativa bënë bashkë 25 nxënës të shkollave të mesme dhe studentë, përfshirë këtu juristë të ardhshëm nga Fakulteti Juridik ,,Iustinianus Primus" dhe studentë nga drejtimet e juridikut nga shkollate mesme ,,Vasil Antevski Dren" dhe ,,Arseni Jovkov".



Ky program i Ditëve të Hapura u ofroi pjesëmarrësve mundësi të rrallë për të parë nga afër punën e brendshme dhe të prapa-skenave brenda gjyqësorit. Gjatë këtyre vizitave, studentët vizituan objektet e gjyqeve dhe u informuan mbi punën e përditshme të departamenteve të ndryshme brenda gjyqeve. Atyre iu dha mundësia të shohin nga afër seanca të vërteta si dhe një Seancë të Përgjithshme të Gjykatës Supreme, duke parë kështu se si në të vërtetë funksionon procesi gjyqësor. Studentët bashkëpunuan edhe me gjykatës duke marrë pjesë në diskutime të hapura lidhur me sfidat e gjyqësorit si dhe me aftësitë thelbësore që duhen për të pasur një karrierë të sukseshme në fushën e drejtësisë.

Këto ngjarje nuk përbëjnë aktivitete të izoluara por janë rezultat i drejtpërdrejtë i Strategjisë së Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatave për Komunikim (2024–2028), që u përpilua dhe miratua me mbështetje strategjike nga projekti ynë. Duke hapur dyert për rininë, gjykatat zbatojnë në mënyrë aktive standarde të reja të transparencës që kanë për qëllim forcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe mbylljen e zbrazëtirave mes institucioneve ligjore dhe qytetarëve të cilëve ato duhet t'iu shërbejnë.

Entuziazmi që treguan studentët dhe transparenca e gjykatave që morën pjesë theksuan vlerën që ka mësimi empirik në fushën e juridikut. Duke u dhënë studentëve qasje të drejtpërdrejtë në organet më të larta të gjyqësorit ne forcojmë promovimin e një komuniteti juridik të mirëinformuar, të angazhuar dhe profesionist për të ardhmen e Maqedonisë së Veriut.



Ndërtimi i kapaciteteve anti-korrupsion udhëhequr nga të dhënat brenda Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit

Në dhjetor 2025 dhe janar 2026, brenda Komponentit 3 të Projektit u mbajt Trajnimi Praktik katër-ditor për Analizë dhe Procesim të të Dhënave. Ky trajnim bëri bashkë 13 punonjës të Sekretariatit të Përgjithshëm të KSHPK, duke forcuar kështu kapacitetet e tyre për mbledhje, procesim dhe analizë të të dhënave mbi parandalimin, detektimin e korrupsionit dhe hetimet administrative.

Duke qenë se puna e anti-korrupsionit bazohet kryesisht në menaxhim dhe interpretim të një vëllimi të madh të të dhënave të strukturuara dhe të pastrukturuara—që nga regjistrat financiar dhe deklarimet e pasurisë deri tek të dhënat e prokurimit dhe grupet e të dhënave me burim të hapur—në këtë trajnim u bë kombinim i teorisë dhe ushtrimeve praktike. Pjesëmarrësit forcuan aftësitë për mbledhje të të dhënave, modelim të të dhënave, dhe analizë të të dhënave, përfshirë lidhjen e grupeve të të dhënave, ndërtim të modeleve analitike, dhe krijim të paneleve interaktive. Poashtu ushtruan edhe pastrimin, bashkimin dhe riformësimin e grupeve të të dhënave me Power Query, duke zbatuar filtrimin, formatimin e kushtëzuar dhe tabelat me rënie për të detektuar tendenca dhe probleme të mundshme.



Një ushtrim tjetër i rëndësishëm ishte edhe analiza e një grupi të të dhënave si shabllon mbi transparencën e shpenzimeve publike, që iu dha mundësi pjesëmarrësve të zbatojnë aftësitë për strukturim, verifikim dhe analizë të të dhënave financiare për mbështetje të kontrollit të integritetit dhe detektimit të parregullsive.

Pjesëmarrësit raportuan që ishin të kënaqur, duke theksuar që përdorimi i të dhënave shembull por edhe i të dhënave të tyre iu ka ndihmuar të përkthejnë mjetet abstrakte në zbatim praktik të punës së tyre të përditshme.


Natasha Stoilkoska, Këshilltare për Statistikë dhe Analitikë tha:


> "Trajnimi shkoi shumë mirë. Progresi ndjehet nga çdo pjesëmarrës. Të përdorurit e të dhënave tona bashkë me ushtrimet ishte diçka shumë e rëndësishme, ngaqë na dëshmoi se si duhet të zbatohen metodat në punën tonë të përditshme."

Borçe Stojanovski, Këshilltar në Sektorin e Monitorimit të Pasurisë, shtoi:

> "Ky trajnim është shumë i rëndësishëm për sektorin tonë. Aktivitetet e ditës në këtë sektor janë regjistrimi dhe monitorimi i pasurive, dhe na vijnë dhumë të dhëna mbi pasuritë e personave të zgjedhur dhe të emëruar. Na ndihmoi që të njihemi më mirë me Excel-in dhe Power BI, që do të mbështesë si analizat statistikore ashtu edhe vizualizimin e raportimit në KSHPK."

Në përgjithësi, trajnimi i dha stafit të KSHPK aftësi praktike, udhëhequr nga të dhënat që do të rrisë cilësinë e punës anti-korrupsion që bazohet në prova dhe që është proaktive. Angazhimi i lartë dhe rezultatet e shkëlqyera nga vlerësimi dëshmojnë që kjo iniciativë ka vendosur një bazë të mirë për forcim afatgjat institucional në një mjedis që bëhet gjithmonë më kompleks dhe më intenziv me të dhëna.





Kalimi nga parimet në praktikë – Hartimi i ligjeve dhe masave përmes Qasjës që ka për Bazë të Drejtat e Njeriut (QBDNJ)

Në Forumin e dytë të Impulseve u bënë bashkë palët kryesore për të drejtat e njeriut nga ministritë, institucionet shtetërore, dhe shoqëria civile që bëri ngjarjen të ketë pjesëmarrje të gjerë të palëve relevante. Pjesëmarrësit ishit ndër të parët që patën mundësi të eksploroojnë doracakun e sapobotuar Doracaku mbi Zbatimin e QBDNJ i disponueshëm në maqedonisht dhe anglisht.

Përmes seancave praktike pjesëmarrësit testuan se si detyrimet e të drejtave të njeriut mund të udhëheqin një cikël të plotë politik—nga vlerësimi i nevojave dhe zbrazëtirave deri tek hartimi i masave për mbrojtje të të drejtave të çdo individi. Qasja që bazohet në të drejtat e njeriut u vlerësua si "tejet e rëndësishme për vlerësim të nevojave dhe zbrazëtirave në fazën përgatitore të ligjeve".

Pjesëmarrësit diskutuan mbi zbatimin e pesë parimeve udhëheqëse të QBDNJ:

- të gjitha të drejtat e njeriut për të gjithë,
- pjesëmarrje me domethënie dhe gjithëpërfshirëse,
- mos-diskriminim dhe barazi,
- llogaridhënie dhe sundim i ligjit,
- transparencë dhe qasje në informacion.

Zbatimi i parimeve ,,transparencë dhe përfshirje" shihet si ,,drejtim drejt zgjidhjeve më të mira dhe mirëqenies për të gjithë."

Një element i rëndësishëm i këtij Forumi ishte të kuptuarit e përbashkët që të siguruarit e pjesëmarrjes kuptimplote dhe gjithëpërfshirëse vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore të zbatimit.

Institucionet zakonisht nuk kanë mekanizma të qarta, burime të mjaftueshme, dhe kohë për të konsultuar të gjitha grupet e prekura—sidomos kur ato janë më pak të dukshme ose nuk janë të përfaqësuara aq sa duhet.

Vetë Forumi dëshmoi vlerën e proceseve pjesëmarrëse me punëtori interaktive, dialogje në grupe, dhe mësim nga bashkëpjesëmarrësit në të gjitha fushat. Pjesëmarrësit vlerësuan lartë ,,ngjarjen e mirë-organizuar me mundësi për të këmbyer përvoja me persona nga institucione të ndryshme", si dhe ,,moderimin dhe interaksionin në grupe".

Forumi i dytë i Impulseve dëshmoi që politikbërja me pjesëmarrje, transparente dhe e bazuar në të drejtë, është si e mundur ashtu edhe e vlerësuar lartë nga institucionet por edhe nga shoqëria civile. Me këtë ngjarje u shënua një hap i rëndësishëm drejt shndërrimit të të drejtave të njeriut në praktikë—forcimi i bashkëpunimit, ndërtimi i kapaciteteve, dhe promovimi i përpjekjeve të përbashkëta për të siguruar të drejta të njeriut për të gjithë.







Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Rritja e transparencës përmes përdorimit të përgjegjshëm të rrjeteve sociale nga prokurorët publikë

Si pjesë e aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të rritjes së komunikimit dhe transparencës së Zyrës së Prokurorisë Publike, Projekti në bashkëpunim me Shoqatën e Prokurorëve Publikë hartoi dhe prezantoi rekomandime për përdorim të rrjeteve sociale nga prokurorët publikë. Këto rekomandime kanë për qëllim ofrimin e udhëzimeve të qarta për të ndihmuar balancin mes lirisë së të shprehurit dhe përgjegjësisë së funksionit të prokurorit në mjedisin digjital të ditëve të sotme.

Edhepse ky dokument është hartuar kryesisht për prokurorët publikë, rekomandimet janë përpiluar me kujdes në mënyrë që të mund të zbatohen dhe të përdoren edhe nga anëtarët e Këshillit, si dhe nga çdo punonjës brenda shërbimit të prokurorisë publike.





Është fakt që prokurorët publikë kanë kufizime më të rrepta në sjelljen e tyre profesionale dhe private në krahasim me profesionet e tjera. Kjo pasqyrohet edhe në aktivitetin dhe postimet e tyre online, ngaqë përmbajtjet që mund të jenë të denja për çdo individ publik mund të shihen si jo të denja për një prokuror, si gjatë orarit të punës ashtu edhe jashtë tij. Prandaj, këto rekomandime nuk duhet të shihen si restriksione, por si mjet praktik për t'iu ardhur në ndihmë prokurorëve publikë për të ruajtur integritetin personal dhe profesional gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Në këtë drejtim, këto rekomandime duhet poashtu të kontribojnë për një ndarje të qartë mes qëndrimeve personale që prokurorët publikë mund të shprehin si persona privatë dhe të dhëna dhe qëndrime oficiale që komunikohen brenda institucionit.

Lufta kundër trafikimit ilegal të drogës – Sesioni II

Në përputhje me përpjekjet e Komponentit 2 për të mbështetur krijimin e njësisë për luftë kundër mjeteve ilegale narkotike, në Shkup u organizua punëtoria njëditore Lufta kundër trafikimit ilegal të drogës – Sesioni II. Në këtë punëtori u bënë bashkë 30 hetues nga Ministria e Brendshme nga nivelet qendrore dhe rajonale (SVR).

Gjatë këtij sesioni fokusi u vendos në strukturën dhe mënyrën e punës të hetimeve penale që kanë të bëjnë me trafikimin ilegal të drogës, duke kombinuar mbledhjen e zakonshme të të dhënave me përdorim të Masave të Posaçme Hetuese (MPH). Një fokus i veçantë iu dha koordinimit dhe bashkëpunimit mes njësive kombëtare, rajonale dhe lokale si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar të policisë.

Përmes diskutimeve të rasteve praktike, pjesëmarrësit këmbyen përvoja, identifikuan sfida të përbashkëta dhe eksploruan zgjidhje që bazohen në hetime të vërteta. Hetuesit forcuan kuptimin e kohës dhe mënyrës së përdorimit të MPH, dhe rritën aftësitë për të trajtuar tendencat në rritje e sipër siç janë llojet e reja të drogave në treg, si dhe rritën kapacitetin për të zbatuar njohuritë e përbashkëta në raste të ngjashme në të ardhmen.



ÇUÇUL ADEM

INTERVISTA

KRYETAR I KOMISIONIT SHTETËROR PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT

Lufta kundër korrupsionit përmes integritetit, pavarësisë dhe ndërtimit të kapaciteteve

1. **Jeni pjesë e Komisionit për Anti-korrupsion pothuajse dy dekada. Nga ky këndvështrim, si kanë ndryshuar sfidat e luftës kundër korrupsionit dhe cilën e konsideroni ju pjesën më kritike për forcim të shtetit ligjor sot?**

Është e vërtetë që jam pjesë ë Komisionit për dy dekada me radhë dhe kam pasur mundësinë të punoj me të gjitha përbërjet e Komisionit Shtetëror për Prandalim të Korrupsionit. Kam parë të gjitha ngritjet dhe rëniet e Komisionit po edhe zhvillimet dhe rritjet e kapaciteteve institucionale brenda KSHPK, si dhe vështirësitë e zbatimit të përgjëgjësive ligjore, duke marrë parasysh kapacitetet e kufizuara financiare dhe te personelit.

Besoj që me miratimin e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konflikteve të interesit në vitin 2019, u bë një ndryshim drastik në statusin dhe kompetencat që ka KSHPK. Mënyra e zgjedhjes së kryetarit dhe anëtarëve të KSHPK ndryshoi, gjë që forcoi transparencën në procesin e zgjedhjes por edhe hapi mundësinë për profesionalizim më të madh, për forcim të integritetit, dhe për ulje të ndikimit politik.

Nga ana tjetër, rritja e pozitës dhe kompetencave të Komisionit pa rritur financat dhe numrin e të punësuarve nuk mjafton për të mbështetur këto ndryshime. Është shumë e rëndësishme që të miratohen analizat e nevojshme funksionale dhe sistematizimi i vendeve të punës dhe të sigurohet pavarësi më e madhe financiare në mënyrë që zbatimi i kompetencave të reja të bëhet efektiv.

Gjatë viteve të fundit është bërë shumë në fushën e ndërtimit të infrastrukturës ligjore për parandalim dhe luftë kundër korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Janë miratuar shumë dokumente ligjore për përafrim me rregullativat evropiane, dhe është formuar strukturë institucionale.

Një sfidë thelbësore për parandalim dhe luftë efektive kundër korrupsionit vazhdon të jetë forcimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për parandalim dhe luftë kundër korrupsionit, forcim i integritetit personal dhe institucional brenda sektorit publik, zbatimi konsistent i ligjeve relevante, zbatim i masave dhe aktiviteteve anti-korrupsion, sidomos ato që parashihen në dokumente kombëtare siç është Strategjia Kombëtare për Parandalim dhe Luftë kundër Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, dhe në fund, dënimi efektiv i korrupsionit.

2. **Bashkëpunimi ynë ka filluar në fillim të këtij projekti. Cilat janë format e mbështetjes dhe ekspertizës që kanë rezultuar si më të nevojshmet për institucionin tuaj gjatë periudhës së shkuar dhe pse?**

Ne e çmojmë dhe vlerësojmë shumë mbështetjen që marrim në kuadër të Projektit Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit. Çdo aktivitet dhe formë mbështetjeje që është dhënë deri tani ka pasur domethënie të madhe për ne dhe ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve tona.

Poashtu do të doja të theksoj mbështetjen e ekspertëve që lidhet me analizë të dobësive dhe nevojave për përmirësim të zgjidhjeve softuerike për raportim dhe monitorim të pasurive dhe interesave. Në këtë drejtim, puna për përpilimin e metodologjisë për detektim të personave deklarimet e pasurive dhe interesave të të cilëve do të jenë subjekt verifikimi në përputhje me Planin Vjetor, përmes analizës së të dhënave nga deklaratat që dorëzohen përmes softuerit është sidomos me rëndësi të madhe.

Aktiviteti i dytë i rëndësishëm që do të doja të theksoj është mbështetja e ekspertëve për përpilim të Strategjisë së Komunikimit të KSHPK përmes analizës së dobësive të detektuara dhe caktimi i masave dhe aktiviteteve për rritje të dukshmërisë së punës të KSHPK dhe për promovim të aktiviteteve dhe masave të tyre anti-korrupsion.



Një aspekt thelbësor i rritjes së aftësive të të punësuarve tanë është trajnimi që ofrohet në kuadër të Projektit për Analizë dhe Procesim të Avancuar të të Dhënave, që forcon aftësitë dhe njohuritë e punonjësve tanë, gjë që ka rëndësi të madhe sidomos për monitorim të statusit të pronës së zyrtarëve.

3. **Për mendimin tuaj si Kryetar, çfarë është e domosdoshme që Komisioni Anti-korrupsion të veprojë në mënyrë të pavarur, konsistente dhe të arrijë rezultate konkrete?**

Kur flasim për një KSHPK të pavarur, autonomia financiare është thelbësore, sidomos përmes ndarjes së buxhetit të nevojshëm që të zbatojë plotësisht detyrimet ligjore. Është shumë e rëndësishme që stafi të jetë profesionist, sidomos në fushat ku janë idenitifkuar dobësi, siç është për shembull monitorimi i pasurive dhe mbikëqyrja e financimit të partive politike gjatë fushatave zgjedhore. Paralelisht me këtë edhe digjitalizimi është shumë i rëndësishëm. Krijimi i një lidhjeje të plotë me bazat e të dhënave të institucioneve nga të cilat marrim të dhëna do të na mundësojë qasje në të dhëna në formë elektronike përmes softuerit, që do e shpejtojë mjaft procesin e mbledhjes dhe zgjerimit të verifikimeve tona.

Ndërkohë për të qenë më efikasë me kapacitetet që kemi për momentin duhet të prioretizohen aktivitetet sipas kapaciteteve momentale financiare, teknike dhe të stafit.

4. **Lufta kundër korrupsionit lidhet ngushtë me sundimin e ligjit. Si pasqyrohet kjo lidhje në punën e përditshme të Komisionit dhe në besimin e qytetarëve?**



Korrupsioni dhe sundimi i ligjit janë dy pole të kundërta. Sa më shumë që sundon ligji brenda një shoqërie aq më pak korrupsion ka, dhe e kundërta. Për të krijuar një shoqëri ku sundon ligji duhen forcuar integriteti personal dhe institucional në institucionet publike. Në qoftë se kemi institucione me integritet që udhëhiqen nga njerëz me integritet, do të kemi edhe sundim të ligjit, ngaqë janë pikërisht institucionet e sektorit publik ato që kanë përgjegjësinë për të zbatuar dhe monitoruar ligjet.

KSHPK ka dy role kryesore. Roli i parë është rritja e vetëdijes për forcim të integritetit personal dhe institucional. Roli i dytë është të reagojë në rastet kur shkilet integriteti me inicim të procedurave të duhura.

Në qoftë se qytetarët njohin rolin që ka KSHPK dhe punën që bën ky komision në këtë fushë do të rritet edhe besimi në punën e tij.

5. **Cilat janë prioritetet kryesore që ka Komisioni Anti-korrupsion për periudhën që vijon, dhe si mund të kontribojë projekti me mbështetje kombëtare apo ndërkombëtare për tu arritur këto qëllime në mënyrë më të qëndrueshme dhe efikase?**

Si komision kemi disa prioritete për periudhën që vjen.

- Miratim dhe promovim i Strategjisë së re Kombëtare për Parandalim të Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave;
- Promovim i integritetit në çdo institucion të sektorit publik, sidomos brenda gjyqësorit;
- Rritja e vetëdijes publike mbi lobimin;
- Forcim i monitorimit të deklarimeve të pasurisë dhe interesave dhe rritja e vëllimit të verifikimit të të dhënave nga deklarimet e dorëzuara, për të cilat duhet përmirësim dhe operacionalizim i softuerit ekzistues.

За поефикасна реализација на наведените и другите приоритети и програмски активности на ДКСК неопходна е соработката и поддршката од нашите меѓународни подржувачи и партнери. Во рамки на веќе воспоставена соработка и обезбедане поддршка предвидени се активности кои ќе бидат поддржани во наредниот период токму за реализација на горенавдените приороитети. Дел од тие активности се повеќегодишни и континуирани и од тие причини поддршката на меѓународните парнери е неопходна да продолжи и во наредниот период.

Forcimi i kapaciteteve për mbrojtje më të madhe nga dhuna seksuale

Tridhjetë prokurorëve publikë dhe gjykatësve iu dha mundësia të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë praktike për trajtim të rasteve të dhunës seksuale në një program të specializuar përgatitur me kujdes. Ky trajnim që u mbajt në bashkëpunim me Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve krijoi hapësirë për diskutim të hapur dhe punë me sfida të vërteta gjyqësore me të cilat ballafaqohen profesionistët gjatë punës së përditshme.

Në këtë trajnim u punua intenzivisht në raste të vërteta, u bënë ushtrime në grup dhe diskutime me fokus në:

- Format e reja të dhunës seksuale dhe procesimi i tyre ligjor dhe juridik,
- Eliminimi i paragjykimeve dhe mbajtja e një ane gjatë arsyetimit ligjor
- Zbatimi i qasjes që bazohet në dakordim dhe trajtimi i qasjeve që marrin për bazë traumën,
- Nevoja për veprim shumësektorial dhe të koordinuar.

Puna dinamike në grup la përshtypje të madhe — pjesëmarrësit në mënyrë aktive identifikuan tregues të dakordimit/mosdakordimit, analizuan gjykime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe diskutuan rrezikun e eskalimit nga dhuna seksuale në femicid. Në veçanti u çmua qasja e trajnerëve, që arritën të mbajnë interesin e pjesëmarrësve dhe inkurajuan këmbimin e ideve.



Këmbimi profesional dhe dialogu konstruktiv dëshmuan edhe një herë rëndësinë që ka rritja e vazhdueshme e trajtimit institucional i dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore. Pjesëmarrësit bënë identifikimin e shembujve se ç'do të praktikonin ata — si për shembull respektimi i viktimës në çdo hap të procedurës, kujdes gjatë procedurave penale dhe evitimi i paragjykimeve për viktimën, që mund të çojnë në vendim të gabuar.

Bashkë ndërtojmë një sistem që mbron, që trajton dhe që ofron drejtësi.



Lidhja e prokurorëve të ardhshmën me praktikën: Dita e Hapur e Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme

Studentët në Programin e Masterit për Drejtësi Penale pranë Fakultetit Juridik ,,Iustinianus Primus" në Shkup morën pjesë në Ditën e Hapur organizuar nga projekti në Zyrën e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë kësaj vizite, përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorisë Publike, Këshilllit të Prokurorëve Publikë, dhe Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë diskutuan me studentët organizimin institucional dhe përgjegjësitë që ka Zyra e Prokurorisë Publike, rolin që ka Këshilli i Prokurorëve Publikë, dhe kontributin e Akademisë për zhvillim profesional dhe mundësitë e karrierës së prokurorëve publikë. U diskutua edhe mbi rolin që prokurorët publikë kanë në procedurën penale dhe punën praktike në raste individuale.

Me këtë formë të drejtpërdrejtë të komunikimit mes studentëve dhe përfaqësuesve të institucioneve gjyqësore, pjesëmarrësve iu dha mundësia të këmbejnë përvojat dhe qëndrimet mbi gjendjen momentale të Zyrës së Prokurorëve Publikë dhe gjyqësorit në përgjithësi.

Kjo ngjarje është pjesë e vazhdës së aktiviteteve që kanë për qëllim forcimin e transparencës së Zyrës së Prokurorisë Publike në raport me opinionin publik.



Forcimi i sistemeve tona të mbështetjes për të plotësuar nevojat e vërteta të viktimave të DHBGJ

Nga 2 deri në 4 dhjetor 2025, mbajtëm me sukses Trajnimin bazik të Trajnerëve në Veles, për fuqizim të profesionistëve nga Qendra e Punës Sociale për mbrojtjen e viktimave nga dhuna me bazë gjinore.

Gjatë tri ditëve frymëzuese, 22 punonjës të dedikuar dhe tri përfaqësues nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë forcuan aftësitë nën udhëheqjen e eksperteve Ljupka Trajanovska, Sanela Shkrjej, Karin Bishof dhe Natasha Boshkova.

Gjatë seancave interaktive, ushtrimeve në grup dhe studimeve të rasteve, si dhe simulimeve praktike pjesëmarrësit eksploruan mundësitë për:

- **Zbatim i qasjeve që bazohen në të drejtat e njeriut dhe tek viktima gjatë trajtimit të DHBGJ**
- **Njohja dhe mbështetja e dimensioneve ndërseksionale të DHBGJ**
- **Identifikimi dhe parandalimi i viktimizimit dytësor**
- **Përmirësimi i vlerësimit të rrezikut, menaxhimi i rasteve dhe referimi i personave të prekur nga DHBJ**
- **Rritja e bashkëpunimit multisektorial për mbrojtje më të madhe institucionale**



Ç’ishte ajo që e bëri këtë trajnim të veçantë?

Një hapësirë e mirëkuptueshme ku profesionistët ndanë përvojat, sfidat dhe shembujt mbi mënyrat e suksesshme dhe rastet e zgjidhura në një mënyrë empatike, thelbësore dhe shumë motivuese. Pjesëmarrësve iu pëlqyen sidomos ,,ushtrimet interaktive, që e bënë të mundur vizualizimin dhe kuptimin më të mirë të mënyrës së punës së tyre”. Poashtu u pëlqeu edhe ,,qasja e re e transferimit të njohurive përmes ushtrimeve në formë loje, interaksioni dhe mbi të gjitha qasja pozitive e trajnerëve. Lulet dhe kollaçet kontribuan që atmosfera të jetë më e relaksuar.” Kjo përvojë trajnimi dëshmon rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme dhe rritjen e profesinalitetit tek ata që janë të parët në trajtim të DHBGJ.





Ky trajnim përbën një hap tjetër të rëndësishëm drejt forcimit të sistemit për mbrojtje të viktimave nga dhuna me bazë gjinore dhe mbështetjes së trajtimit institucional më efektiv, sensitiv dhe të mirë-koordinuar.

Presim me padurim trajnimet e radhës dhe interaksionin mes pjesëmarrësve dhe ekspertëve për të forcuar më tutje kapacitetet për punë me personat e prekur nga DHBGJ.

NËNTOR 2025 - SHKURT 2026

KALENDARI NGJARJET E ARDHSHME

PRILL

Trajnime mbi komunikimin me Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorinë Publike

Komponenti 1

PRILL

Tryezë e rrumbullakët mbi Etikën Gjyqësore

Komponenti 1

16 PRILL

Kursi Akademik i IACA-s mbi Korrupsionin dhe Mashtrimin në Prokurimin Publik

Komponenti 3

MARS

Prezantimi i Strategjisë Kombëtare për Krimin e Organizuar

Komponenti 2

24 SHKURT

Forumi Nr. 3 për të Drejtat e Njeriut – Burrat Ndërmarrin Veprime për Barazinë Gjinore

Komponenti 4

31 SHKURT

Trajnim mbi mjetin e monitorimit të PKA-së për të drejtat e fëmijëve

Komponenti 4

EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

IMPRINT

Botues: Ludwig Boltzmann Gesellschaft - Instituti i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut (LBI-GMR), Vjenë, në kuadër të Projektit ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit", Shkup
Redaktoi: Kristina Vesikj
Lektura: Ane Petrushevska
Periudha e raportimit: 8 nëntor 2025 - 7 shkurt 2026
Data: 7 shkurt 2026

Financuar nga Bashkimi Evropian

BE-ja me TY